

AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE " DILO " SH.P.K.

Bazuar ne ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" une Andrea Dilo, i datelindjes 13.08.1951, qytetar shqiptar me banim ne Tirane, Rr."Myslym Shyri" Nr.18, Themeloj Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin " DILO " SH.P.K.

Neni 1

" DILO " eshte person juridik shqiptar, i cili fiton te drejten te ushtroje veprimtarine e tij qe nga data e miratimit nga organet kompetente shqiptare. Shoqeria DILO e zhvillon aktivitetin e tij ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktet e themelimit (ky akt dhe statuti bashkelidhur tij).

Neni 2.

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane, (Shqiperi) prane pallatit te sportit. Ajo ka te drejte te krijojte gjetke dhe jashte shtetit filiale, agjensi, seli sekondare dhe ti suprimoje ato.

Neni 3.


Objekti i aktivitetit ekonomik te Shoqerise DILO do te jete:

- Eksport - Import dhe prodhim i artikujve industriale, ushqimore, te ndertimit, si dhe pjeseve te kembimit per makineri dhe automjete.
- Transportin e mallrave, te pasagjereve si dhe aktivitet te autoshkollave.
- Eksport - Import dhe tregetim karburantesh.

Per realizimin e qellimeve te mesiperme Shoqeria ka te drejte:

- Te marre pjese ne fitime, kuota, pjesemarrje aksionare, ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.
- Te kryeje cdo lloj operacioni te luajtshem dhe te paluajtshem industrial,

tregtar dhe financiar.

- 
- Objektet e aktivitetit te Shoqerise DIL0 jane edhe marreveshjet e saj me persona te tjere juridike Shqiptare te cilat pershkruhen ne menyre konkrete ne statut dhe rregullohen nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Neni 4.

Pergjegjesia e ortakut ne Shoqerine DIL0 eshte e kufizuar.

Shoqeria DIL0 nuk pergjigjet per detyrimet e tanishme dhe te mevoneshme te ortakëve.

Neni 5.

Kapitali themeltar i Shoqerise DIL0 eshte 100.000 (njqindmije) leke i perbere nga shumat e dardhura na natyre dhe na te holla.

Ortaku ka te drejte te kontribuoje ne kapitalin e Shoqerise DIL0 duke transferuar ne pronesi te saj leke dhe te mira materiale.

Kuota ne leke do te depozitohet nga ortakut prane nje banke Shqiptare ku do te hapet llogaria likujduese.

Neni 6

Kohezgjatja e Shoqerise eshte fiksuar per dhjete vjete te rinovueshem.

Ky rinovim do te behet mbi bazen e autorizimit te marre prane organerve kompetente Shqiptare, mbi bazen e kerkeses se bere nga pala shqiptare.

Neni 7

Te drejtat dhe detyrat e ortakut te vetem jane:

- Te marre pjese ne administrimin e drejtimin e Shoqerise.
- Te terheqe fitimin e realizuar.
- Te terheqe aktivin rezultues nga bilanci i likujdimit ne rast te pushimit te aktivitetit te Shoqerise.
- Te derdhe kapitalin themeltar sikunder eshte stabilizuar ne nenin 5.
- Te ruaje sekretin e aktivitetit te Shoqerise.
- Te impenjohet ne realizimin e objektivave te Shoqerise.

Neni 8

Organet e Shoqerise DIL0 jane:

- Ortak i vetem
- Administratori
- Keshili Revizionit.

Menyrat e formimit dhe funksionimit te tyre do te pershkruhen ne statutin e Shoqerise.

Ortak i vetem dhe themelues i Shoqerise eshte Andrea Dilo.

Administrator i vetem i Shoqerise DIL0 emerohet Andrea Dilo.

Keshilli i Revizionit do te perbehet nga dy anetare te zgjedhur midis eksperteve ligjore dhe kontabel.

Neni 12

Te gjitha dispozitat e detajuara te Shoqerise DIL0 jane pershkruar ne statutin bashkengjitur.

Neni 14

Ky Akt u perpilua ne gjuhen shqipe ne tre ekzemplare origjinale.

Tirane, _____ Gusht 1994.

T H E M E L U E S I

Andrea Dilo



S T A T U T

I SHOQERISE TERGETARE " DILLO " SH.P.K.

Shoqeria Tregetare " DILLO " Sh.P.K. eshte krijuar mbi bazen e aktit te themelimit te ortakut te vetem Andrea Dillo, qytetar shqiptar me banim ne Tirane.

K R E U I

EMERTIMI

Neni 1

Shoqeria Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuar qehat " DILLO " SH.P.K. Shoqeria "DILLO" eshte person juridik shqiptar i cili fiton te drejten te ushtroje aktivitetin e saj nga data e miratimit te kontrates se themelimit dhe statutit nga ana e organeve kompetente shqiptare.

Neni 2

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit (akti i themelimit dhe ky statut).

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 3

Objekti i veprimtarise se Shoqerise DILLO do te jete:

- Eksport - Importi dhe prodhimi i artikujve industriale, ushqimore, te ndertimit si dhe pjese kembimi per makineri dhe automjete.
- Transportin e mallrave, te pasagjereve si dhe aktivitet te autoshkollave.
- Eksport - Import dhe tregetim karburantesh.

Per realizimin e qellimeve te mesiperme shoqeria ka te drejte:

- Te marre pjese ne fitime, kuota dhe pjesemarrje edhe aksionare, ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.
- Te kryeje e cdo lloj operacioni te luajtshem dhe te paluajtshem, industrial, tregtar dhe financiar.

SELIA

ka qendren ne Tirane, prane pallatit te sportit " Asllan
vejte te krijoje gjetke dhe jashte shtetit, filiale,
qesi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

K R E U II

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT

Neni 5

Ortaku gezon keto te drejta dhe detyra themelore:

- Te administroje dhe drejtoje Shoqerine.
- Te terheqe ftimin e realizuar.
- Te shperndaje aktivin rezultues nga bilanci i likujdimit, ne rast te pushimit te aktivitetit te shoqerise.
- Te derdhi kuoten e kapitalit themeltar.
- Te ruajne sekretin e aktivitetit te shoqerise.
- Te impenjohet per realizimin e objektivave te saj.

Neni 6

Ortaku ka te drejte tu cedoje te treteve pjese te kapitalit te shoqerise duke i bere ata pjesemarres ne shoqeri, si ortake me kuote te percaktuar. Cedimi i pjeseve te kapitalit nuk e liron ortakun nga detyrimet qe ka marre ne te kaluaren ndaj Shoqerise dhe nuk nderpret detyrat e saj ndaj ortakut cedues.

Neni 7

PERGJEGJESIA

Pergjegjesia e ortakut ne Shoqerine DILD eshte e kufizuar. Shoqeria DILD nuk pergjigjet per detyrimet e mepareshme dhe te mevoneshme te ortakut.

K R E U III

KAPITALI, BILANCI DHE FITIMET

Neni 8

Per zhvillimin e aktivitetit te Shoqerise DILD eshte themeluar nje kapital prej 100.000 leke.

Neni 9

Shoqeria është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe disponon në emrin e saj në përputhje me objektin dhe qëllimin e aktivitetit të saj.

Shoqeria është e lirë të zotërojë dhe shfrytëzojë të drejtat materiale, përfshirë të drejtën të japë me qira pronat e saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Në Shqipëri Shoqeria DILLO gëzon të drejtën e mbrojtjes së pronave të saj si çdo shoqëri tjetër.

Neni 10

Shoqeria mund të krijojë fondin e rezervës dhe fonde të tjera të vecanta financimi.

Përdorimi i çdo fondi të vecantë përcaktohet nga Administratori.

Shoqeria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

Detyrimet që mund të lindin gjatë aktivitetit të saj do të mbulohen vetëm nga pasuria e Shoqërisë.

Neni 11

Pasuria e Shoqërisë DILLO është e llogaritur në bilanc me vlera të shprehura në lekun shqiptar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Forma e bilancit dhe e llogarive ekonomike të Shoqërisë përcaktohen nga organet Administrative të Shoqërisë, duke respektuar formën e bilancit dhe të llogarive ekonomike parashikuar nga ligji për shoqëritë tregtare.

Neni 12

Planet financiare do të shprehen në lek dhe në valute të huaja.

Rezultatet financiare të aktivitetit të shoqërisë do të përcaktohen në bazë të bilancit vjetor.

K R E U I V

ORTAKU I VETEM

Neni 13

Ortaku i vetëm është organi që vendos për aktivitetin e shoqërisë.

Neni 14

Thirrja e tij behet nga Administratori me nje leter rekomande i cili cakton gjithashtu nje sekreatre per te mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

Neni 15

Ortakut i vetem merr vendime kur:

- Aprovohet bilanci
- Emerohet Administratori si dhe anetaret e Keshillit te Revizionit
- Modifikohet akti i themelimit dhe statuti.
- Emerohen subjektet e ngarkuara per likuidimin.
- Vendos per probleme te tjera lidhur me drejtimin e Shoqerise, te rezervuara keto ne kompetence te tij.

ADMINISTRATORI

Neni 16

Administrimi i aktivitetit ekonomik te Shoqerise do te realizohet nepermjet Administratorit te emeruar nga ortakut i vetem sic eshte percaktuar ne kontraten e themelimit.

Neni 17

Administratori do te qendrojne ne detyre per tere periudhen e ekzistences se Shoqerise.

Ortakut i vetem gezon te drejten te shkarkoje Administratorin.

Neni 18

Administratori mund te emeruje ne cdo moment nje zevendes, te cilin ka te drejte ta shkarkoje ne cdo kohe.

Neni 19

Kompetencat e Administratorit jane:

- Percaktimi i orientimeve themelore te programit dhe buxhetit.
- Miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike, pas perpunimit te tyre sipas objektit te veprimtarise.
- Percaktimi i rregjimit dhe kushteve te llogarise ekonomike.

- Perfundimi i dokumentave normative qe percaktojne raportet brenda shoqerise, perfshire personelin.
- Percaktimin e organikes drejtuese.
- Krijimin e organizmave te tjera te pavarura per realizimin e objektivave dhe funksioneve te shoqerise.
- Percaktimin e modalitetave per derdhjen e kuotave perberese te kapitalit.
- Paraqitjen e propozimeve Ortakut rreth perdorimit te fondeve te vecanta.
- Pergatitjen e propozimeve lidhur me pushimin e aktivitetit te Shoqerise
- Percaktimin e kerkesave per finacim.

KESHILLI I REVEZIONIT

Neni 20

Per kontrollin e aktivitetit financiaro-tregetar te Shoqerise krijohet Keshilli i Revizionit.

Anetaret e ketij keshilli emerohen nga Oratku i vetem, midis eksperteve ligjore, administrativ dhe kontabel.

Keshilli i Revizionit i paraqit Ortakut te vetem ne fund te cdo viti bilancin vjetor.

Neni 21

Kur Shoqeria do te likujdohet, Ortaku emeron komisionin e likujdimit i cili i paraqit atij bilancin e likujdimit.

Shoqeria perfundon aktivitetin e saj ne momentin e aprovimit te ketij bilanci dhe pasuria rezultuese i kalon Ortakut te vetem.

Neni 22

Ky statut eshte perpiluar dhe firmosur ne tre kopie origjinale ne gjuhen shqipe.

Tirane me Gusht 1994

T H E M E L U E S I

Andrea Dilo

